



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.4.2023

Nr:352

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E KOHËS SË TRANSMETIMIT NË RADIOTELEVISIONIN PUBLIK TË FUSHATËS  
ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE TË REGJISTRUARA SI SUBJEKTE ZGJEDHORE, PËR  
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n”, e 2, 80, 81, 84 dhe 84/1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V Ë R E J:

Neni 80, pika 1, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se radiotelevizioni publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të bërë fushatë.

Në zbatim të nenit 80, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton minutazhin për partitë parlamentare, sipas numrit të vendeve në Kuvend që ato kanë marrë në zgjedhjet e fundit, si dhe për partitë joparlamentare.

Partive parlamentare, të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, KQZ-ja i cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 (tridhjetë) minutash në televisionin publik dhe po aq në radion publike. Për partitë e tjera parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) minuta.

Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 (dhjetë) minuta në televisionin publik dhe 10 (dhjetë) minuta në radion publike.

Data: 13.4.2023 Nr: 352  
Ora: 12:00



“Për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Bazuar në nenin 80, pika 1, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përllogaritur kohën në dispozicion të subjekteve zgjedhore, duke u bazuar në regjistrimin e tyre për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021, duke përcaktuar numrin e mandateve të fituara nga secili subjekt zgjedhor. Duke u bazuar në numrin e mandateve të fituara në zgjedhjet e fundit për Kuvendin, rezultoi se:

Partitë parlamentare, të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, janë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë
2. Partia Demokratike

Partitë e tjera parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më pak se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, janë:

1. Partia Socialdemokrate
2. Partia e Lirisë
3. Partia Republikane Shqiptare
4. Partia “Drejtësi, Integrim dhe Unitet”
5. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë
6. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
7. Partia “Aleanca Progresiste L.ZH.K”
8. Partia Lëvizja e Legalitetit

Duke analizuar nenin 80 pika 1, shkronja “b”, minutazhi falas ju vihet në dispozicion partive politike të regjistruara apo koalicionit, bazuar në parimin e proporcionalitetit të numrit të konkurrentëve në garë. Konkurrenca politike në garë matet nga numri i subjekteve zgjedhore të cilat kanë dorëzuar kandidatët për kryetar bashkie dhe listat shumemërore për kandidatët për anëtar të këshillave bashkiakë. Neni 65, pika 3 i Kodit Zgjedhor përcakton se të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

Si subjekte zgjedhore pjesëmarrëse për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, janë regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe parti politike joparlamentare që konkurrojnë më vete apo si parti pjesëtare në koalicione, të cilat në zbatim të nenit 80, pika 1, shkronja “c”, përfitojnë 10 (dhjetë) minuta në televizionin publik dhe 10 (dhjetë) minuta në radion publike.

Gjithashtu, si subjekte zgjedhore pjesëmarrëse për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, janë regjistruar edhe kandidatë për kryetar bashkie të propozuar nga zgjedhësit dhe kandidatë për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga zgjedhësit, të cilët sipas praktikës së krijuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe radiotelevizioni publik, duhet të përfitojnë 5 (pesë) minuta në televizion dhe 5 (pesë) minuta në radion publike.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n”, e 2, 80, 81, 84 dhe 84/1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

### **V E N D O S:**

1. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 50 (pesëdhjetë) minutash në televizionin publik dhe 30 (tridhjetë) minutash në radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore si më poshtë:
  - a) Partia Socialiste e Shqipërisë
  - b) Partia Demokratike
2. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 25 (njëzetë e pesë) minutash në televizionin publik dhe 15 (pesëmbëdhjetë) minutash në radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partisë parlamentare si më poshtë:
  - a) Partia e Lirisë
  - b) Partia Socialdemokrate
  - c) Partia Republikane Shqiptare
  - ç) Partia “Drejtësi, Integrim dhe Unitet”
  - d) Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë
  - dh) Partia “Aleanca Progresiste L.ZH.K”
  - e) Partia Lëvizja e Legalitetit
  - ë) Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut
3. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 10 (dhjetë) minutash në televizionin publik dhe 10 (dhjetë) minutash në radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive joparlamentare, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 5 (pesë) minutash në televizionin publik dhe 5 (pesë) minutash në radion publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për secilin prej kandidatëve për kryetar bashkie dhe anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga zgjedhësit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



NR.	SUBJEKTI ZGJEDHOR	SHKRONJAT NISTORE
1	Partia Demokracia Sociale	P.D.S
2	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	ADK
3	Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	P.M.D.E
4	Partia e Gjelbër	P.GJ
5	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar	PBD
6	Partia Ora e Shqipërisë	P.O.SH
7	Partia Kombëtare Konservatore Albania	PKKA
8	Partia Demokristiane e Shqipërisë	PDK
9	Aleanca Arbnore Kombëtare	AAK
10	Partia Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorve të Shqipërisë	P.M.D.P.SH
11	Partia Emigracionit Shqiptar	P.E.Sh
12	Partia Komuniste e Shqipërisë	PKSH
13	Partia Qytetare Shqiptare	P.Q.SH
14	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	MEGA
15	Partia Unitetit Kombëtar	PUK
16	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	ABDE
17	Lëvizja punëtore Shqiptare	P.L.P.SH
18	Partia Shqiptare Atdheu	PSHA
19	Nisma Thurje	NTH
20	Partia Konservatore	KONS
21	Balli Kombëtar Demokrat	PBKD
22	Partia Kristian Demokrate e Shqiperise	PKDSH
23	Lëvizja e RE	LRE
24	Bindja Demokratike	BD
25	Partia Balli Kombëtar	P.B.K
26	Lidhja Demokristiane Shqiptare	L.D.K
27	Personat me Aftësi të Kufizuar	PPAK
28	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	AD
29	Aleanca Demokracia e Re	ADR
30	Aleanca Maqedonasve për integrimin European	A.M.I.E
31	Ardhmëria Shqiptare	PASH
32	Bashkimi Liberal Demokrat	BLD
33	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	ADS
34	Fryma e Re Demokratike	FRD



35	Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë	PEISH
36	Fronti i Majtë	FM
37	Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	P.R.D.Sh
38	Lëvizja Bashkë	BASHKE

